



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 27 gusht 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1276_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25 dhe Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Neni 16.8 Dispozitat e Rregullave të Tregut të aprovuara me vendimin V_1066_2018 të datës 30 tetor 2018 nga Bordi i ZRRE-së,
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të datës 08.07.2020, për aprovim të ndryshimit të koeficienteve të humbjeve të OSSH, si dhe për lejimin për ti aplikuar korrigjimet e nevojshme për periudhat e mëparshme.

në seancën e mbajtur me datë 27 gusht 2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** - kërkesa e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për ndryshim të koeficienteve të humbjeve të OSSH, me të drejtën e ndryshimit të tyre në rast të nevojës më së shumti në intervale kohore një (1) mujore.
- II. REFUZHET** - kërkesa për ti aplikuar korrigjimet e nevojshme për periudhën e mëparshme.

A r s y e t i m

- ZRRE me datë 08.07.2020 ka pranuar kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për aprovim të ndryshimit të koeficienteve të humbjeve të OSSH.
- Në kërkesën sqaruese të OSSH poashtu është kërkuar që ZRRE duhet të lejoj korrigjimet për periudhën e mëparshme, bazuar në të dhënat e realizuara, të cilat si të tilla do të ishin i vetmi



mekanizëm i mundshëm dhe i drejtë për të siguruar shpërndarje të saktë të kostove të realizuara nëpërmjet pjesëmarrësve të tregut dhe OSSH-së, për më tepër kjo është një domosdoshmëri për të aplikuar drejtësisht rregullat e tregut dhe eviton çfarëdo subvencionimi të mundshëm nëpërmjet OSSH-së dhe furnizuesve në një treg të liberalizuar.

- Poashtu, OSSH-ja, ka kërkuar që t'i lejohet deklarimi i koeficienteve të humbjeve të energjisë elektrike më së shumti në intervale kohore 1 (një) mujore, me të drejtë ndryshimi në raste të nevojës, dhe lejimin për t'i aplikuar korrigjimet e nevojshme për periudhat e mëparshme, ku qëllimi i vetëm është optimizimi dhe shpërndarja e drejtë e kostove të jo-balanceve në dobi të sistemit dhe pjesëmarrësve të tij.
- ZRRE, bazuar në nenin 16.8 të Rregullave të Tregut, dërgon te palët koeficientet për llogaritjen e humbjeve në shpërndarje. Këta koeficientë shfrytëzohen nga OSSH për blerjen e energjisë së nevojshme për mbulimin e humbjeve dhe nominimin e sajë në baza orë për orë. Meqenëse këta koeficientë merren nga bilanci vjetor i energjisë elektrike i aprovuar nga ZRRE, ndërsa përgatitja e bilancit fillon shumë më herët se fillimi i realizimit të parashikimeve, atëherë saktësia e koeficienteve zvogëlohet dhe kjo ndikon në jobalancet e OSSH-së.
- OSSH për nevoja të kalkulimit të Jobalanceve, do të trajtohet si Palë Tregtare e cila duhet ta ketë në bilanci Energjinë e Matur të regjistruar në Llogarinë Dalëse dhe Nominimet Kontraktuale për energjinë e blerë për humbjet në rrjetin e shpërndarjes, dhe do të jetë përgjegjëse për Jobalancet kur paraqiten mospërputhje në mes Humbjeve në Shpërndarje të regjistruara dhe shumës së Nominimeve Kontraktuale.
- ZRRE, duke pasur parasysh efektin e përcaktimit të hershëm të koeficienteve për llogaritjen e humbjeve në shpërndarje, dhe pas kërkesës së OSSH ka analizuar çështjen e ndryshimit të koeficienteve dhe ka parë si të arsyeshme kërkesën e OSSH për ndryshimin e tyre për periudhat e ardhshme me të drejtën e ndryshimit të tyre në rast të nevojës më së shumti në intervale kohore një (1) mujore, ndërsa sa i përket kërkesës për ti aplikuar korrigjimet e nevojshme për periudhën mëparshme është refuzuar, dhe si të tilla janë vendosur si në dispozitiv të vendimit.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi V_1265_2020 i datës 23 qershor 2020 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, do të shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së,




Arsim Janova, u.d. Kryesues



Besim Sejfiqaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KEDS Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së